



## Forumi Musliman i Shqipërisë

### Islamofobia në Shqipëri

#### Raporti vjetor 2018 –

#### Hyrje

Islamofobia në vend mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për bashkësinë muslimane shqiptare dhe pasojat e saj në përditshmërinë e besimtarëve. Viti 2018 reflektoi po ato probleme që kanë të bëjnë me paragjykimet dhe stereotipet e krijuara tashmë nëpërmjet mediave zyrtare apo edhe rrjeteve sociale prej vitesh. Mbulesa e femrës muslimane vazhdon të jetë një nga problemet më delikate me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për t'i dhënë zgjidhje. Një e dhënë jo e mirë është se gjuha islamofobike përdoret edhe nga gazetarë profesionistë, të cilët me opinionet e tyre përdorin shprehje të tilla. Pas një eksperience tre-vjeçare me problemet e hasura në përditshmërinë njerëzore vërejmë se problemet themelore janë po ato, madje edhe mund të jenë ashpërsuar vende-vende për shkaqe nga më të ndryshmet. Problemeve të islamofobisë ju shtohen edhe problemet që kanë njerëzit në përgjithësi, duke parë që shoqëria shqiptare nuk ka gjetur akoma stabilitetin e duhur, madje mungesa e stabilitetit dhe problemet e ndryshme sociale e rëndojnë edhe më situatën. Bashkësia muslimane me problemet e saj, nuk qëndron jashtë shoqërisë. Përpjekje nga grupe të ndryshme muslimane dhe individë për përmirësim imazhi nëpërmjet bamirësisë dhe “zbutjes së plagës së varfërisë” ka pasur vazhdimisht vitin e kaluar dhe kjo ka

ndikuar sadopak në këtë drejtim. Islamofobia gjithashtu është një fenomen që nuk mund të shihet i ndarë nga ndikimet e ndërsjella dhe interaktiviteti në fusha të ndryshme të jetës njerëzore si politika e shoqëria, por edhe në marrëdhëniet e ndryshme që vendosin njerëzit dhe lëvizja e lirë e tyre.

Ndërkaq vërehet një integrim pozitiv i elementit musliman në të gjitha fushat, porse etiketimet “islamik”, “me burka e ferexhe” vazhdojnë rëndom dhe ndihet efekti i presionit disavjeçar mediatik, i cili do të vazhdojë edhe për disa kohë.

### **Vështrim i përgjithshëm mbi ngjarjet e vitit 2018**

Në kuadrin e të drejtave dhe të zbatimit të tyre nga institucionet e ndryshme, qofshin ato jo-shtetërore dhe të sektorit privat, po ashtu edhe në shtet, nuk ka ndonjë përmirësim të dukshëm. Ankesat e ardhura pranë FMSH-së janë po ato, ku Mbulesa e Femrës Muslimane, e drejta për ta ushtruar fenë në publik, gjuha islamofobike, hate speech e fenomene të ngjashme me to vazhdojnë të jenë një shqetësim për të gjithë besimtarët e bashkësisë muslimane. Një apati në këtë drejtim vërehet edhe nga strukturat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, kundrejt të cilëve ka pasur ankime nga shtesa të ndryshme besimtarësh nga Tirana dhe qytete të tjera mu për këto probleme. Besimtarët i kanë konsideruar si të vakëta reagimet e KMSH-së për ngjarje të ndryshme, sidomos me deklaratat e kryeministrit Edi Rama mbi “radikalizimin e myslimanëve” në fillim të vitit që shkoi. Strukturat shtetërore dhe nëpunësit kanë një mungesë të theksuar të njohjes minimale të kuadrit juridik mbi të cilin funksionojnë institucionet ku punojnë. Njëkohësisht nuk dinë të bëjnë dallimin midis të qenit të institucionit laik dhe bindjeve njerëzore, ku hyn edhe e drejta e ushtrimit publik të fesë. Kjo u vërejt edhe me hartimin e strategjisë kombëtare dhe **“Modulet e trajnimit kundër terrorizmit në sistemin parauniversitar”**, ku dalloheshin gjurmët e një pune të përshpejtuar. Fryma që nxitet nga hate speech kundrejt muslimanëve ndihet e pranishme nga ana mediatike, po ashtu kjo bëhet më e prekshme në rrjetet sociale, ku njerëzit ndjehen të lirë të shprehen në hapësirat e tyre personale, në interaktivitet me njëri-tjetrin në profile dhe në faqet e ndryshme, të cilat mund të klasifikohen sipas identiteteve njerëzore me përkatësi politike apo

lokale. Janë disa analistë dhe gazetarë që vazhdojnë të shkruajnë apo flasin me etiketa të ndryshme islamofobike, që vazhdojnë të gjenerojnë këtë lloj fryme të papranueshme. Shihet një ndërhyrje e panevojshme e strukturave arsimore në qelizat e familjes, të cilat sjellin diskriminim gjinor edhe në veshje. Të gjitha këto do t'i gjeni sipas rubrikave në vijim të këtij raporti, ku secili rast është i dokumentuar.

## **Mbulesa e Femrës Muslimane**

Mbulesa e femrës muslimane tashmë është kthyer në një tipar të zakonshëm të jetës së përditshme në qytetet tona. Megjithatë realiteti tregon zhvillime të tjera, ku rregullisht femrat e mbuluara sulmohen pikërisht për shkak të veshjes së tyre dhe të paraqitjes së tyre në publik dhe mënyrat, se si është reaguar tregojnë paragjykim dhe diskriminim për shkak të veshjes dhe të bindjeve fetare.

### **Refuzohet të intervistohet për shkak të mbulesës**

Znj. A. S. i refuzohet intervista me justifikimin se vendi i punës është i zënë tashmë. Pas një takimi të lënë nëpërmjet një telefonate për t'u intervistuar dhe për t'u punësuar në sektorin privat znj. A. S. i është refuzuar vazhdimi i procedurave të zakonshme për t'u intervistuar dhe punësuar më pas nga punonjësja, e cila ishte në pritje të publikut. Madje ajo ka treguar përçmim me formën e shprehur gjatë bisedës ndaj znj. A. S. Ngjarja ka ndodhur më 17 gusht 2018 në një institucion privat në Tiranë dhe është denoncuar haptas nga vetë personi në fjalë.

### **Sulmohet për shkak të mbulesës**

Një mësuese edukatore kopshti është sulmuar nga një grup prindërisht për shkak të mbulesës së saj. Mësuesja Q.X., e cila që prej më shumë se 20 vitesh shërben në kopshtin për fëmijë shtetëror të Krrabës, Tiranë është sulmuar nga një grup prindërisht, të cilët i kanë kërkuar asaj "të largohet nga vendi i punës se shteti është laik". Në këtë konflikt mësuesja ka reaguar, se mbulesa është pjesë e besimit dhe liria e besimit garantohej nga ligjet dhe kushtetuta e këtij vendi. Këta

prindër kanë kërkuar ta mediatizojnë çështjen për t'i bërë presion dhe për ta larguar nga vendi i punës znj. Q.X. Problemi u mbyll pa pasoja për Q.X. dhe ajo vazhdon të jetë e punësuar. **(Tetor 2018)**

### **Largohet nga puna për shkak të mbulesës**

Një grua e mbuluar e punësuar si punëtore e thjeshtë në sektorin privat në zonën industriale të fshatit Vaqarr, pranë Tiranës pas rreth një muaji e gjysmë punësim është larguar nga puna dhe nuk i është dhënë paga e plotë. Në bazë të informacionit znj. N.P. u punësua në një fabrikë ambalazhi shishesh në zonën industriale të Vaqarrit. Procesi i punës në këtë fabrikë e kërkon që gratë e punësuarat aty të mbulojnë kokën, ndërkaq pas një periudhe kohore prej gati dy muajsh e punësuar i kërkohet të përdori uniformën e punës, ku i kërkohet të heqi mbulesën e kokës dhe të përdori uniformën e kërkuar nga firma private, që e kishte punësuar. Nëpunësi i firmës megjithëse N.P. ka pranuar të veshi uniformën e firmës, por në vend të shamisë së kokës të firmës i ka kërkuar të mbajë mbulesën e gruas muslimane, pra ky nënpunës nuk ka pranuar gjithsesi, dhe ka këmbëngulur që të veshi krejt uniformën, përndryshe të largohet nga vendi i punës. Pas disa ditësh përpjekje për mirëkuptim me drejtuesit e kësaj firme private, N.P., është detyruar të largohet, dhe nuk ka arritur të marrë pagën e plotë, që i takonte për ditët që kishte punuar pranës kësaj firme. **(Nëntor 2018)**

### **Sulme islamofobike ndaj mbulesës në media**

Mustafa Nano: Gratë muslimane nuk duhet të mbajnë hijabin, por duhen gra me b\*\*e për ta bërë këtë

Mustafa Nano, mbrëmjen e sotme në emisionin e tij “Provokacia” që transmetohet në “ABC News”, gjatë monologut të tij, ka rrëfyer historinë e Masih Alinejad, një gazetareje me origjinë iraniane, e cila më parë ka mbajtur hijab, por pas largimit për në SHBA, e ka hequr atë.

“Sipas saj, gratë që duan ta mbajnë, le ta mbajnë. Sepse kështu janë ato vetë që zgjedhin ta mbajnë. Mirëpo, sipas meje në këtë pikë e ka gabim. Ajo dhe të gjithë

ata që mendojnë si ajo, sidomos një numër intelektualësh të majtë në Perëndim, që nuk shqetësohen kur shohin një grua myslimane të mbuluar “me vullnetin e dëshirën e saj”. Madje, e inkurajojnë ta bëjë këtë. Dhe nuk e çojnë në mendje se nuk ka gra që vendosin me kokë të tyre të mbulohen. Nuk janë gratë pra që vendosin. Është një kulturë e tërë patriarkale që iu imponohet, e që nuk u lë zgjedhje tjetër, veçse të veshin hijabin”, shkruan ai. (5 qershor 2018)

<http://www.panorama.com.al/mustafa-nano-grate-myslimane-nuk-duhet-te-mbajne-hijabin-por-duhen-gra-me-be-per-ta-bere-kete/>

Mentor Kikia

9 gusht 2018 ·

Për burrat që i mbajnë gratë në thasët e persekutimit

Për të gjithë ata që mu sulën, pas publikimit të një shkrimi, lidhur me cënimin (sipas meje) e të drejtave të grave që mbulohen me burka. Sepse ata burra, ndjehen mirë që i mbajnë gratë e tyre brenda thasëve të zinj, sepse kështu mendojnë se ruajnë nderin, sepse kështu nuk ua shikon as dielli e as robi, as duart, as fytyrën e as sytë.

<https://www.facebook.com/mentor.kikia/photos/a.1640918689495867/2185756795012051/?type=1&theater>

Fatkeqësisht këto lloj sulmesh të llogaritura nga opinionistë të shoqërisë civile shkaktojnë rregullisht për pasojë një gjuhë urretëse nga komentuesit e ndryshëm kudo nëpër rrjetet sociale.

## **Modulet e trajnimit kundër terrorizmit në sistemin parauniversitar**

Në Janar 2018, nisi iniciativa më e re e Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me trajnimin e punonjësve të sistemit publik arsimor mbi Parandalimin dhe Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shkolla. Forumi

Musliman i Shqipërisë e përshëndet këtë iniciativë të dobishme, si dhe është në mbështetje të plotë të iniciativave të tilla.

Në këtë kuadër Forumi Musliman i Shqiptërisë, si dhe shumë persona influent, drejtues fetarë, dhe institucionet jo-qeveritare brenda komunitetit të besimtarëve muslimanë kanë qenë dhe janë aktivë në mbrojtjen e grigjës së besimtarëve nga manipulimet e ndryshme në emër të fesë dhe narrativave shterpe, të cilat nuk janë në përputhje me vlerat dhe principet fetare, të cilat derivojnë nga revelatat hyjnore, ku bazohet feja jonë.

Ekstremizmi i Dhunshëm është një fenomen, i cili përbën një problematikë që nuk pranohet nga imamët, këshillat e xhamive, teologët dhe i gjithë komuniteti i besimtarëve. Manipulimet në emër të fesë, zhvillimi i agjendave për përfitime të grupeve të ndryshme apo promovimi i narrativave dhe retorikave ekstremiste janë në vëmendje të plotë të shoqërisë muslimane shqiptare. Të gjithë komponentët e këtij komuniteti kanë dekada që punojnë në adresimin, si dhe parandalimin e këtyre narrativave, edhe pse këto iniciativa çuditërisht, nuk pasqyrohen në nivelin e duhur në media me gjithë këmbënguljen tonë. Vetë komuniteti i besimtarëve muslimanë është një nga grupet e interesit më të angazhuara dhe të shqetësuara nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Fatkeqësisht, moduli i trajnimit është realizuar pa pasur në të dhe kontributin e komponentit më kompetent mbi këtë çështje... pra të vetë përfaqësuesve të grigjës së besimtarëve muslimanë. Në një vështrim të hollësishëm që i kemi bërë këtij moduli, mendojmë që ky lloj trajnimi nuk do të jetë, as efektiv, dhe as eficient në trajtimin e çështjes. Përkundrazi, moduli në vetvete promovon marginalizim, si dhe krijimin e stereotipeve në shoqëri. Ne mendojmë se ky marginalizim i tejskajshëm, që do të prodhohet nga mosnjohja e fesë dhe mungesa e edukimit të saj nëpërmjet kurrikulave të studiuara mirë do të sjelli rritjen e dozave të islamofobisë në shoqëri, që edhe kështu është tejet i lartë.

Modulet e ofruara nga ky trajnim vuajnë nga mungesa e informacionit të duhur, i cili është marrë i shkëputur nga vende të ndryshme dhe pothuajse pa asnjë lidhje me kontekstin shqiptar. Nisur nga ky shqetësim, kërkojmë rishikimin e moduleve

ku jemi të gatshëm të japim kontributin tonë, jo vetëm si palë interesi, por edhe si njohës të mirëfilltë të manipulimeve të retorikave fetare, indikatorëve të këtij lloj ekstremizmi problematik, si dhe ekspertizën dhe eksperiencën shumë frytdhënëse të cilën neve mbartim.

## **Takimi Rama – Merkel**

Në një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel kryeministri shqiptar Edi Rama në mënyrë indirekte ka paralajmëruar se myslimanët shqiptarë mund të radikalizohen nga ndikimet e jashtme ruse,- për këtë një grup besimtarësh kanë shprehur shqetësimin e tyre për këto lloj deklarimesh. Kësaj deklarate i është bashkuar edhe kryetari e sekretari i FMSH-së Fisnik Kruja e Roald Hysa:

Ne, një grup besimtarësh myslimanë dëgjuam me shqetësim deklaratat e Kryeministrit Edi Rama të datës 25 prill 2018 në Berlin, të cilat kriminalizojnë me një gjuhë islamofobe myslimanët shqiptarë. Në deklaratat e tij, Kryeministri paralajmëron kancelaren gjermane dhe Bashkimin Europian se mos-integrimi i Shqipërisë në BE do të krijojë hapësirë për Rusinë që të radikalizojë myslimanët shqiptarë. Stigmatizimi, përveçimi dhe portretizimi i tyre me këtë negativitet e përshkallëzon etiketimin e bërë nga disa elita kulturore të vendit se myslimanët shqiptarë dhe feja e tyre janë një pengesë për integrimin europian të Shqipërisë.

## **Sjellje dhe qëndrime islamofobike në arsimin parauniversitar**

### **Incidente në shkollën Fan Noli dhe 1 Qershori në Tiranë me rastin e fillimit të Ramazanit**

Ngjajnë si raste pa lidhje nga njëri-tjetri, dhe pavarësisht nga mënyrat në fund qëllimi ka qenë i njëjti, pikërisht ndalimi i praktikave të ndryshme fetare dhe ndalimi i agjërimit. Prindër muslimanë të shqetësuar nga aktiviteti, që i tejkalon

kompetencat ligjore të edukimit i kanë denoncuar këto lloj praktikash nga personeli i shkollave Fan Noli dhe 1 qershori.

Pas denoncimeve të bëra publike mbi një ngjarje të paprecedent në shkollën Fan Noli ne e shohim si një ndërhyrje të pavend në jetën private të fëmijëve dhe të familjeve të tyre se si duhet të sillen apo si duhet të veprojnë gjatë muajit të madhnueshëm të Ramazanit. Pak a shumë e njëjta situatë ka ndodhur edhe në shkollën 1 qershori, ndërkohë që nga denoncimi i prindit kuptohet qartë se ka pasur një diskriminim për veshjen dhe paraqitjen e jashtme të fëmijës. Këto janë ndërhyrje pa vend dhe që shkojnë në dëm të zbatimit të ligjshmërisë nëpër shkolla, po ashtu shkaktojnë shqetësime të panevojshme familjare.

### **Mësuesja “këshillon të mos agjërojnë muajin e shenjtë”**

Mësuesja Etleva Meço, që ka në kujdestari njëri nga klasat e gjashta në shkollën “Fan S. Noli”, pasi mori informacion nga nxënësit e klasës nëse anëtarë të familjeve të tyre agjërojnë ose jo, i “këshilloi ata që të mos agjëronin muajin e shenjtë islamik”. Sipas saj, kjo “porosi” e konsultuar me mjeken e shkollës është një udhëzim i drejtpërdrejtë i drejtorisë së shkollës.

Pas një deklaratë publike të FMSH-së për këtë rast dhe një rast të ngjashëm në shkollën 1 qershori në kryeqytet, FMSH-ja ju drejtua me një letër drejtorisë së shkollës “Fan Noli” (po ashtu edhe DAR- Tirana) dt. 23 maj 2018, ku i tërhiqej vëmendja, se mësuesja në fjalë kishte shkelur ligjin në më të paktën 14 nene të ndryshme, ku ruhen të drejtat e fëmijëve nga legjislacioni shqiptar dhe konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Shteti Shqiptar. Mësuesja në fjalë ka ndërhyrë krejtësisht pa vend në marrëdhëniet fëmijë-prind, të cilat janë themelore për problemet e lirisë së besimit. Brenda kësaj dite drejtoresha e shkollës Fan Noli ka kontaktuar në një bisedë telefonike kryetarin e FMSH-së Fisnik Kruja, ku i ka kërkuar falje dhe ka garantuar verbalisht për motivet e mira të mësueses.

### **Prindi A.A. denoncon psikologun e shkollës 1 qershori**

Bëhet fjalë për shkollën 1 Qershori në kryeqytet, shkollë në të cilën mëson edhe vajza ime në klasën e dytë. Ajo është nxënëse e shkëlqyer, sistematike dhe e edukuar. Që në fillim të klasës së parë ajo ka shkuar në shkollë e veshur me rroba



të gjata deri tek nyjet e këmbëve dhe kyçet e duarve. Para dy tre javësh psikologia e shkollës gjatë pushimit të madh e thërret në zyrë dhe duke lajkatur e pyeti gjerë e gjatë për çështje të ndryshme, që kishin të bënin me familjen tonë. E pyeti rreth xhamisë duke pretenduar se kishte dëshirë edhe ajo që të shkonte dhe më pas e pyeti vajzën, se a shkonte në xhami apo jo. Pastaj bashkë me vajzën time filloi të hulumtonte te profili im i facebookut. Më pas filloi të hulumtonte te profili i facebookut i bashkëshortes time, ku u çudit se ajo ishte e mbuluar komplet madje edhe fytyrën. Atëherë e pyeti vajzën se pse mami i saj nuk mban shami si gratë e tjera por e mbulon fytyrën komplet. Pas kësaj filloi t'i fliste vajzës time për veshjen e saj duke i treguar se edhe tutat nuk kane ndonje të keqe që ti vishte në vend të fustaneve dhe fundeve të gjata. I tha se nuk i pëlqente sjellja e prindërve të vajzës, të cilët e veshin vetëm me rroba të gjata. Në fund psikologia i sugjeroi vajzës që mos të vishej me rroba të gjata por me tuta e veshje të tjera derisa të mbushte moshën 17 vjeç e pastaj të zgjidhte vetë si të dëshironte. Kur vajza më lajmëroi për këtë ngjarje vendosa të shkoja ta takoja vetë psikologen. Pas asaj dite psikologia ka shkuar në një rast në klasë dhe ka kërkuar ta merrte në zyrën e saj duke e shkëputur nga ora e mësimit, por nuk është lejuar nga mësuesja kujdestare. Në dy raste të tjera në oborrin e shkollës i ka bërë me shenjë vajzës, që t'i shkonte pas por vajza ka refuzuar, ashtu siç e udhëzova unë. Ndërsa dje në orën e parë të mësimit u fut në klasë dhe pasi i komunikoi diçka një fëmije tjetër, ju afrua vajzës dhe i tha: Ka filluar edhe Ramazani po ti a do agjërosh? Vajza ju përgjigj se do agjëronte. Atëherë ajo shtrembëroi buzët dhe u largua. **maj 2018**

## Të ndryshme

### Dy mësuesve ju mohohet leja për të falur xhumanë

Dy mësuesve në zonën e Krrabës, Tiranë pasi kanë kërkuar leje në drejtori për të falur xhumanë ju është mohuar e drejta e tyre për ushtrimin e besimit edhe në publik. Të dy këta mësues kanë kërkuar rregullisht për të shkuar për të falur xhumanë në xhaminë që ndodhet pranë shkollës së tyre në fshatin Ibë, Krrabë e Tiranës, por iu është refuzuar largimi nga mjediset e shkollës me justifikimin që

shteti është laik. Mësuesit u shprehën të indinjuar për mënyrën se si po paragjykohe nga drejtoria e shkollës, për një gjë që është e garantuar me Kushtetutë dhe ligjet e ndryshme të nxjerra nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe nga Kartat Ndërkombëtare të nënshkruara nga Shteti Shqiptar. Mësuesit A. A.- dhe D.F.- janë paraqitur pranë FMSH-së dhe kanë kërkuar asistencë ligjore për të zgjidhur këtë problem. **Dhjetor 2018**

## **Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë përdorin mjediset e Xhamisë së Namazgjasë**

Forcat policore të Ndërhyrjes së Shpejtë kanë përdorur si strehim të tyre kantierin e Xhamisë së Namazgjasë, megjithëse protestat studentore që kanë shpërthyer qysh në fillim të dhjetorit kanë qenë krejtësisht paqësore dhe pa asnjë lloj incidenti. Shumë besimtarë janë ndjerë të ofenduar nga ky shfrytëzim arbitrar i kësaj situate të nderë nga forcat policore, ndërkohë që ky incident është raportuar dhe përhapur gjerësisht në rrjetet sociale.

## **Gjuhë islamofobike në gazetari**

Për Enton Abilekajn, drejtorin ekzekutiv të Fax News kjo është një ditë e zezë për historinë e medias në Shqipëri, ku qeveria ia ka dalë që të monopolizojë transmetimet, duke favorizuar disa klientë të saj. Sipas tij sot gjysma e Shqipërisë është në errësirë. Një errësirë si ajo e republikave islamike, ku televizioni është i ndaluar, ose lejohen vetëm TV që kalojnë censurën. Ekranet nxijnë, televizorët janë tepër nëpër shtëpitë e varfra. (10 shtator 2018)

<https://www.faxweb.al/sot-eshte-dita-me-e-zeze-per-televizionet-abilekaj-per-transmetimet-dixhitale-ekranet-nxijne-qeveria-ia-doli-te/>

Një tjetër problem i mbartur dhe i pazgjidhur ende është ai i besimtarëve me uniformë të rekrutuar në ushtri apo në sektorë të ndryshëm të rendit, të cilëve iu ndalohet falja krejtësisht gjatë orarit të punës dhe që nuk iu jepet asnjë shans nga

organet e Ministrisë së Mbrojtjes për të gjetur një zgjidhje të përbashkët. Disa prej tyre kanë paraqitur prej kohësh pranë zyrave të FMSH-së ankesa dhe kanë deklaruar, se po persekutohen nga drejtuesit e tyre ushtarakë, duke mos iu lënë atyre asnjë mundësi zgjidhjeje të problemit të paraqitur. Ata ende ndjehen të kërcënuar jo vetëm në të drejtat e tyre themelore të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, por edhe me humbjen e vendit të punës, e për pasojë edhe humbje financiare, me të cilat ata janë përgjegjës për mbarëvajtjen e familjeve të tyre.

Ky problem është i përsëritur dhe ende nuk ka gjetur një zgjidhje të përshtatshme për të interesuarit. Vërejmë se në pjesën më të madhe të reparteve të Forcave të Armatosura, dhe të Rendit ka një numër të konsiderueshëm besimtarësh, të cilët shërbejnë me devotshmëri dhe me profesionalizëm në radhët e ushtarakëve me uniformë ose jo. Po ashtu shumë prej tyre kanë shërbyer edhe në misionet jashtë vendit në kuadër të misioneve të ndryshme ushtarake në Afganistan, Irak, Çad e Bosnje, ku edhe nuk kanë hasur ndonjë pengesë nga mikpritësit e tyre për të ushtruar lirisht dhe në publik besimin e tyre. Ndërkaq praktikat e ndjekura prej kohësh nga vendet mike të Shqipërisë, si Franca, Gjermania, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, NATO deri edhe Afrika e Jugut i kanë zgjidhur këto probleme nëpërmjet legjislacionit dhe ushtarët muslimanë në këto vende gëzojnë të drejtat e faljes, ushqimit hallall, shërbimit psikologjik e shpirtëror dhe të varrosjes sipas rregullave fetare të Islamit.

FMSH është e gatshme të bashkëpunojë me këdo, duke shikuar rrugët e mundshme ligjore për t'i dhënë një zgjidhje në përputhje me Kushtetutën e RSH-së këtij problemi dhe do të mbetet një prioritet i punëve të FMSH-së për këtë vit.

P.S. Forumi Musliman i Shqipërisë synon të rrisë vëmendjen e politikës dhe publikut shqiptar në luftë kundër Islamofobisë dhe racizmit, të monitorojë incidentet e Islamofobisë dhe racizmit, dhe të punojë për të eliminuar diskriminim fetar dhe racor, dhe të lobojë për çështje me interes për muslimanët e Shqipërisë dhe komunitetet e tjera të vendit.